REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISE

EKONOMIA DHE BUXHETI

ECONOMY AND BUDGET

QERSHOR - JUNE
2006

TIRANE

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISE

Raporti Mujor

Qershor 2006

Personi i kontaktit: Luiza JANO
Telefon: ++355 4 258437
E-mail: macro.director@minfin.gov.al
www.minfin.gov.al

PERMBAJTJA

1. VECORITE KRYESORE.....4

2. TIPARE TË TABELAVE SPECIFIKE.....6

   a. IÇK DHE TREGUES TË TJERË.....8
   b. SEKTORI FISKAL.....11
   c. SEKTORI I JASHTEM…… …….13
   d. SEKTORI MONETAR……...……..14

3. TABELAT MBËSHTETËSE

   a. Indeksi i Çmimeve të Konsumit
   b. Kursi i këmbimit
   c. Buxheti i konsoliduar
   d. Shpenzimet institucionale
   e. Shpenzimet sipas funksionit
   f. Investimet
   g. Të ardhurat sipas burimeve
   h. Të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik
   i. Financimi i defiçitit
   j. Mjete valutore neto
   k. Krediti i brendshëm
   l. Oferta e parasë
   m. Depozitat sipas burimeve

1. VECORITE KRYESORE :

- **Indeksi i çmimeve te konsumit** ne muajin Qershor 2006, arriti ne 109.2 perqind, duke shenuar nje renie mujore prej -0.7 përqind, pas renies prej - 0.4 perqind dhe 0.6 perqind, perkatesisht ne muajt maj dhe prill. Norma vjetore e inflacionit, per muajin Qershor ishte 2.4 perqind, duke qendruar brenda objektivit te Bankese se Shqiperise, prej 2 – 4 perqind.



- **Kursi mesatar i kembimit** te monedhes vendase me dy monedhat kryesore te huaja, per muajin Qershor 2006, ishte:

  - 97.18 leke per dollare
  - 123.09 leke per euro



Ne muajin Qershor, monedha vendase, ndoqi trendin e saj te nencmim kundrejt dy monedhave te huaja,monedhes europiane, Euros dhe kundrejt dollarit amerikan. Sjellja e monedhes sone ne tregun vendas eshte reflektimi i sjelljes se dy monedhave ne tregjet nderkombetare monetare si dhe i nderhyrjeve ne treg nga ana e Bankes se Shqiperise.

- Gjate muajit Qershor 2006, **normat e interesit te depozitave** 12-mujore ne leke, kane pesuar nje renie ne vlere absolute prej 0.03 perqind krahasuar me muajin Maj, ku normat e interesit ishin 5.08 perqind. Ne muajin Qershor 2006 normat e interesit te depozitave 12-mujore ne leke arriten koten e 5.05 perqind.

Renie te lehte per kete muaj kane pesuar depozitat me afat 6-mujor, 3-mujor dhe 1-mujor, te krahasuara me muajin paraardhes (Maj '06) respektivisht me 0.11 perqind, 0.11 perqind dhe 0.01 perqind. Rrenie te lehte prej 0.01 perqind kane pesuar normat per depozitat me afat 24-mujor, te cilat arriten nivelin e 5.90 perqind.

Krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare, rritjen me te larte vjetore e kane patur normat e interesit te depozitave 12-mujore dhe 3-mujore, respektivisht me rreth 1.16 perqind dhe 0.66 perqind.

Normat e interesit te depozitave



	Qersh'05	Korr '05	Gusht '05	Shtat '05	Tet '05	Nent '05	Dhje'05	Jan '06	Shku '06	Mars '06	Prill '06	Maj '06	Qersh'06
12-M	3.89	4.06	4.42	5.28	5.32	5.45	5.57	5.50	5.34	5.28	5.10	5.08	5.05
6-M	3.77	3.72	3.90	4.55	4.75	4.89	4.77	4.95	4.71	4.80	4.60	4.46	4.35
3-M	3.08	3.02	3.13	3.87	4.11	4.17	4.07	4.33	3.41	3.96	3.95	3.85	3.74

❖ Situata buxhetore

Ne fund te muajit Qershor 2006, situata buxhetore, paraqitet si vijon:

1. **Deficiti i pergjithshem** buxhetor arriti ne rreth +10.09 miliarde leke, ose rreth -27.55 perqind e deficitit buxhetor per vitin 2006.
2. **Te ardhurat gjithsej** arriten ne rreth 105.44 miliarde leke ose rreth 47.55 perqind e programit vjetor 2006.
3. **Shpenzimet buxhetore** arriten ne rreth 95.35 miliarde leke, ose rreth 36.90 perqind e totalit te shpenzimeve buxhetore te planifikuara per gjithe vitin 2006.



❖ **Deficiti i pergjithshem** arriti ne +10.09 miliarde leke nga -5.28 miliarde leke te parashikuar per kete periudhe 6-mujore, duke tejkaluar kufijte e parashikuar.

❖ **Të ardhurat gjithsej** arritën në rreth 47.55 përqind të parashikimit vjetor. Ato përfshijnë:

- Mbledhjet e te ardhurave tatimore nga administrata e tatimeve dhe doganave në 49.62 përqind të programimit vjetor;
- Kontributet për sigurimet shoqërore prej 47.51 përqind;
- Të ardhurat jo-tatimore 50.32 përqind e buxhetit vjetor; dhe

- Të ardhurat nga pushteti lokal, 50.97 përqind e planifikimit vjetor

Megjithëse shpenzimet totale ishin rreth 36.90 përqind e buxhetit vjetor, **shpenzimet korrente** arriten ne rreth 87.06 miliardë lekë ose rreth 42.47 përqind e programimit vjetor, pjesërisht si rezultat i shpenzimeve të larta në pagesat e interesit me rreth 40.27 perqind te buxhetit vjetor, te shpenzimeve per sigurimet sociale me rreth 47.27 përqind e buxhetit vjetor dhe i shpenzimeve operative dhe te mirembajtjes me rreth 40.56 perqind e buxhetit vjetor.

a. Sektori Fiskal

Buxheti i Konsoliduar

Ne fund te muajit Qershor, jane mbledhur rreth 105.44 miliarde leke te ardhura, perkundrejt shpenzimeve te pergjithshme prej 95.35 miliarde leke, qe perfshijne 87.06 miliarde leke ne shpenzime korente dhe 8.28 miliarde leke shpenzime kapitale.

Si rrjedhim, deficiti ishte ne nivelin e +10.09 miliarde leke.

Mbledhja e te ardhurave perben rreth 47.55 % te te ardhurave buxhetore per vitin 2006, ndersa shpenzimet perbejne 36.90 % te buxhetit te planifikuar. Shpenzimet korente jane rreth 42.47 % e planifikimit vjetor, ndersa shpenzimet kapitale jane rreth 17.92 % e ketij planifikimi.
Nga te ardhurat gjithsej, pjesa e te ardhurave te mbledhura nga Drejtoria e Pergjithshme te Tatimeve dhe Doganave eshte rreth 72.11 miliarde leke (ose rreth 49.62 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), te ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 5.71 miliarde leke (50.97 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore 19.01 miliarde leke (47.51 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), dhe te ardhurat jo-tatimore ne nivelin e 8.31 miliarde leke (50.32 % e te ardhurave vjetore te planifikuara).

Nga totali i shpenzimeve korente prej 87.06 miliarde leke, 25.28 miliarde leke (29 %) eshte shpenzuar per personelin, 12.16 miliarde leke (14 %) per interesat, 8.64 miliarde leke (10 %) per shpenzime operative dhe mirembajtje, 1.2 miliarde leke (1 %) per subvencione, 27.93 miliarde leke (32 %) per shpenzimet e

sigurimeve shoqerore dhe shendetsore dhe 7.06 miliarde leke (8 %) per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe 4.71 miliarde leke (5 %) per shpenzimet e tjera.

Keto perfaqesojne 43.07 % (shpenzime personeli), 40.27 % (shpenzime per interesat), 40.56 % (shpenzime operative dhe te mirembajtjes), 49.41 % (subvencione), 47.27 % (sigurimet shoqerore dhe shendetsore), 33.15 % dhe 40.84 % (per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) perkundrejt buxhetit te planifikuar vjetor.

Shpenzimet kapitale arriten ne rreth 8.28 miliarde leke nga te cilat 68 % financim i brendshem, dhe 32 % financim i huaj.

Shpenzimet kapitale me financim te brendshem llogariten per kete periudhe ne rreth 23.76 % te buxhetit te parashikuar vjetor, ndersa financimi i huaj eshte vetem 11.76 %.

Suficiti prej 10.09 miliarde leke eshte i barabarte me -27.55% te deficitit buxhetor per 2006.

Të ardhurat sipas Burimeve / Klasifikimit Ekonomik

Te ardhurat gjithsej arriten në fund të muajit Qershor 2006 ne rreth 105.44 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore ne rreth 96.48 miliardë, grantet 277 milione dhe të ardhurat jo-tatimore ne rreth 8.31 miliardë;

Nga totali i të ardhurave tatimore, rreth 72.11 miliardë lekë janë mbledhur nga administrata e doganave dhe e tatimeve, 5.71 miliardë lekë të ardhura nga pushteti lokal dhe 19.01 miliarde leke nga kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore;

Nga të ardhurat totale të mbledhura deri në fund të Qershorit:

- TVSH përbënte 33.35 miliardë lekë
- Tatimi mbi fitimin 11.46 miliardë lekë
- Taksa doganore 7.06 miliardë lekë
- Taksat nacionale 6.50 miliardë lekë
- Akcizat 10.00 miliardë lekë
- Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë 2.03 miliardë lekë;

Financimi i Deficitit

Suficiti prej 10.09 miliardë lekë, ne fund te Qershor, ishte -110 përqind me financim të brendshëm dhe 10 përqind me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm, ndersa per financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

❖ Bilanci i pagesave

Bilanci i pagesave per tremujorin e pare 2006, rezultoi me nje sufiçit te pergjithshem prej 15.6 milion euro. Kjo ishte rezultat i nje:

- defiçiti te Llogarise Korente, prej rreth 164.3 milion euro;
- suficiti te Llogarise se Kapitalit, prej rreth 36.0 milion euro;
- sufiçiti te Llogarise Financiare, prej rreth 55.9 milion euro;
- bilanci pozitiv ne "Gabime dhe harresa neto" prej rreth 88.1 milion euro.

Komponentet kyc te defiçitit te **Llogarise Korente** prej 164.3 milion euro ishin nje:

- bilanc tregtar negativ prej 370.8 milion euro;
- defiçit prej 36.6 milion euro ne bilancin e sherbimeve;
- suficit prej 42.3 milion euro ne bilancin e te ardhurave;
- suficit prej 200.8 milion euro ne transfertat/ te ardhurat nga emigrantet.

- **Oferta totale e parase,** e matur nga M3 arriti në 594 miliardë lekë në fund të muajit Qershor, duke shenuar një rritje prej rreth 10 perqind, krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare.



Kjo rritje vjetore, erdhi si pasoje e rritjes se **depozitave pa afat** ne leke me rreth 105 perqind, depozitave ne valute me rreth 22 perqind, uljes se depozitave me afat ne leke me rreth 11 perqind dhe rritjes te parase jashte sistemit me rreth 4 perqind.



Ndikimin kryesor ne rritjen e ofertes monetare gjate muajit Qershor e kane patur rritja e depozitave pa afat ne leke, te cilat vetem gjate ketij muaji u rriten me rreth 1.35 miliarde leke. Depozitat me afat ne leke pesuan nje renie prej rreth 1.54 miliarde leke kete muaj, ndersa depozitat ne valute pesuan nje rritje per kete muaj me rreth 3.64 miliarde leke.

2. TIPARE TE TABELAVE SPECIFIKE:

b. Indeksi i Çmimeve te Konsumit dhe tregues të tjerë:

Indeksi i Çmimeve te Konsumit

Indeksi i Cmimeve te Konsumit, per muajin Qershor '06 pesoi nje renie prej -0.7 perqind, krahasuar me muajt Maj dhe Prill, kur ky indeks ishte perkatesisht -0.4 perqind dhe 0.6 perqind. Ndryshimet respektive ne te njejtet muaj te nje viti me pare ishin -0.5 perqind, -1.1 perqind dhe -0.3 perqind.

Rritjen me te madhe mujore, per kete muaj e shenoi grupi "Mallra dhe sherbime te ndryshme" me 2.1 perqind. Rritje e cila erdhi si rezultat i ndryshimit te tarifave te sigurimit te automjeteve. Te cilat pesuan nje rritje prej 46.4 perqind, por pesha specifike relativisht e vogel qe ze ky grup ne shporten e mallrave te konsumit (rreth 2.4 perqind), ben qe edhe ndkimi i saj i drejteperdrejte ne inlacionin vjetore per kete periudhe te jete i vogel.

Gjate ketij muaji rritje shenoi edhe indeksi i cmimeve te konsumit per grupin "Pije alkolike dhe duhan" me 0.3 perqind, qe erdhi si rezultat i rritjes se cmimit te cigareve per kete muaj me rreth 0.4 perqind.

Uljen me te madhe per kete muaj e pesoi indeksi i cmimeve te grupit "Ushqim dhe pije jo alkolike" me 2.9 perqind. Ulja e cmimeve per kete grup erdhi si pasoje e uljes se cmimeve per nengrupet "zarzavate perfshi patatet" me 17 perqind dhe "Fruta" me 3.7 perqind.
Nengrupi "peshk" gjate ketij muaji pesoi nje rritje te lete me 0.9 perqind.

Norma vjetore e inflacionit ne muajin Qershor arriti ne 2.4 perqind duke qendruar brenda objektivit te Bankes se Shqiperise.

Ndryshimet vjetore te indeksit te çmimeve te konsumit, ne perqindje, per vitet 2005 dhe 2006 paraqiten ne tabelen e meposhtme :

	Jan	Shku	Mars	Prill	Maj	Qer	Korr	Gusht	Shta	Tet	Nen	Dhj.
2005	3.3	1.8	1.6	1.3	2.0	2.9	1.8	2.3	3.1	3.3	3.0	2.0
2006	1.4	1.3	1.5	2.4	3.1	2.4						

Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i kembimit te lekut me dollarin amerikan, gjate muajit Qershor shenoi nje rritje te prej 0.9 perqind kundrejt muajit maj 2006. Ne fund te muajit Qershor, dollari amerikan arriti nivelin 97.08 leke/dollare.

Kursi mesatar i kembimit te lekut kundrejt dollarit amerikan ne muajin Qershor 2006, arriti ne 97.18 leke/dollare.

Kursi mesatar i kembimit te lekut kundrejt Euros ne muajin Qershor 2006, arriti ne 123.09 Leke/Euro, duke shenuar nje rritje te lehte prej 0.09 perqind krahasuar me nje muaj me pare. Ne fund te muajit Qershor nje euro u kembye me 123.27 leke.

Gjate ketij muaji, ashtu si nje muaj me pare u konstatua nje nencmim i lehte i lekut kundrejt dy monedhave kryesore, monedhes europiane Euros prej rreth 0.09 perqind dhe kundrejt dollarit amerikan prej rreth 0.9 perqind.

Ne krahasim me muajin Qershor te vitit te kaluar rezulton se monedha shqiptare eshte zhvleresuar ndaj dollarit amerikan ne masen 4.4 perqind dhe eshte vleresuar kundrejt monedhes europiane, Euro me 0.44 perqind.



Nencmimi i lekut, kundrejt monedhes europiane Euro dhe kundrejt monedhes amerikane, ne rradhe te pare eshte i lidhur me ecurine e tyre ne tregjet monetare nderkombetare, duke reflektuar sjelljen e tyre ne tregun e brendshem monetar. Kursi i kembimit te euros me dollarin amerikan pesoi nje rritje mesatare te lehte duke arritur ne rreth 1.267 dollare/euro.

Nder faktoret e brendshem qe kane ndikuar ne ecurine e monedhes vendase gjate muajit mars permendim: normen reale te interesave ne leke me te larte se normat ne valute, rritja e besimit te publikut ne sistemin financiar dhe e biznesit tek monedha vendase situata e

konsoliduar makroekonomike, situata e konsoliduar buxhetore, politikat efektive fiskale dhe monetare te ndjekura gjate kesaj periudhe, teprica e likuditetit ne tregun e parase etj.

Interesi i huave 12-mujore gjate muajit qershor pesoi nje renie te konsiderueshme prej 0.93 perqind, duke arritur ne 11.80 perqind nga 12.73 perqind qe ishte ne muajin maj. Per kete muaj normat per interesin e huave 6-mujore pesuan nje renie me 0.85 perqind, krahasuar me nje muaj me pare. Interesi i huave 6-mujore per muajin qershor arriti ne 11.28 perqind.



Normat e interesit te bonove te thesarit gjate muajit qershor 2006, per bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor, ishin perkatesisht, 5.74 perqind, 5.42 perqind dhe 5.23 perqind. Nder faktoret kryesor qe kane ndikuar ne uljen e metejeshme te yield-eve ka qene permirsimi i likuiditeteve ne treg si dhe si dhe uljes se kerkeses se qeverise per kete mjet financiar.

c. Sektori i Jashtëm

Bilanci i Pagesave

Tiparet kryesore të bilancit të pagesave për periudhen Janar - Mars 2006 ishin:

Nje sufiçit i pergjithshem ne bilancin e pergjithshem, prej 15.6 milion euro, rezultat ky i nje:

- defiçiti te Llogarise Korente, prej 164.3 milion euro;
- suficit te Llogarise Kapitale, prej 36.0 milion euro;
- sufiçit te Llogarise Financiare, prej 55.9 milion euro;
- bilanci pozitiv ne Gabime dhe Harresa neto“ prej 88.1 milion euro;



Komponentet kyc te defiçitit te Llogarise Korente prej 164.3 milion euro ishin nje:



- bilanc tregtar negativ prej 370.8 milion euro;
- deficit prej 36.6 milion euro ne bilancin e sherbimeve ;
- suficit prej 42.3 milion euro ne bilancin e te ardhurave ;
- suficit prej 200.8 milion euro levizjet e transfertave dhe dergesave.

Zërat kryesorë në flukset pozitive në llogarinë kapitale dhe llogarine financiare përfshijnë:

- flukset pozitive të investime portofoli prej 4.6 milionë euro;
- flukset pozitive të kapitaleve të tjera prej 48.4 milionë euro;

d. Sektori Monetar

Mjetet Valutore Neto te sistemit bankar

Gjate muajit Qershor 2006, sistemi bankar ka shenuar rritje te mjeteve valutore neto, ne rreth 264.9 milione Usd krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare.

Ecuria e M.V.N te sistemit



	Qersh 05	Korr 05	Gusht 05	Shtat 05	Tetor 05	Nent 05	Dhje 05	Jana 06	Shku. 06	Mars 06	Prl 06	Maj 06	Qersh 06
M.V.N	1,915.6	1,933.1	2,028.3	2,067.0	2,080.7	2,047.2	2,009.7	2,108.4	2,084.2	2,102.5	2,146.5	2,197.9	2,180.5

Kjo rritje ka ardhur si pasoje e rritjes se mjeteve valutore neto ne Banken e Shqiperise, me 249.8 milione Usd dhe rritjes se mjeteve valutore neto te bankave te nivelit te dyte, me rreth 15.1 milione Usd.

Ne muajin Qershor sistemi bankar rezulton me nje renie prej 17.4 miline Usd ne mjetet valutore neto, krahasuar me nje muaj me pare (Maj'06), renie e cila erdhi si rezultat i renies se nivelit te mjeteve valutore neto ne Banken e Shqiperise, me 17.6 milione Usd ne krahasim me muajin prill si dhe rritjes se mjeteve valutore neto te bankave te nivelit te dyte me rreth 0.2 milione Usd.

Kredia per ekonomine

Teprica e kredise per ekonomine ne fund te muajit Qershor 2006 arriti ne 152.8 miliarde leke. Rritja e teprices së kredise, krahasuar me nje vit me pare shenoi vleren 56.9 miliardë leke, me nje rritje prej rreth 59 përqind. Kredia e akorduar nga sistemi bankar edhe gjate kesaj periudhe te vitit 2006, ka qene ne rritje, duke vazhduar keshtu trendin pozitiv te nisur qe ne vitin 2005.

Nga struktura e teprices se kredise sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valute, duke perbere rreth 71.8 perqind te totalit te treprices se kredise.

Kete muaj u vu re qe pesha specifike e kredive per individet, pesoi nje rritje te lehte prej 0.4 perqind, duke arritur ne nivelin 32.3 perqind.

Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), per muajin qershor ka shenur nje rritje te lehte prej 1.06 perqind, karahasuar me nje muaj me pare. Kjo oferte arriti ne rreth 594 miliardë lekë në fund të muajit qershor duke shenuar nje rritje te konsiderueshme prej 16.3 miliarde leke kundrejt nivelit te rregjistruar ne muajin dhjetor 2005. Rritja vjetore e ketij treguesi ishte 10 perqind, duke pesuar ulje te ketij ritmi krahasuar me 18.3 perqind qe ishte gjate muajit qershor 2005. Ngadalësimi i ritmit të ofertës monetare është reflektuar kryesisht në preferenca e individeve per te investuar ne bono thesari, gje qe ka cuar ne uljen e depozitave ne leke.
Niveli i parase jashte bankave eshte rritur me 2.7 miliarde leke ne krahasim me muajin maj dhe 2.8 miliarde leke krahasuar me muajin prill 2006. Rritja vjetore e ketij treguesi ishte 4 perqind.

Raporte te parase jashte bankave



	Qer 05	Kor 05	Gus05	Sht05	Tet 05	Nen05	Dhj 05	Jan,06	Shk06	Mar-06	Prill06	Maj06	Qer06
PJB/M3	25.1	25.4	25.1	25.0	24.6	24.7	25.9	24.5	24.0	23.7	23.7	23.5	23.7
PJB/Depozite	33.5	34.0	33.5	33.3	32.7	30.2	34.9	32.5	315	310	310	30.7	311

Raporti i parase jashte bankave ndaj ofertes monetare, ne fund te muajit qershor arriti ne 23.7 perqind duke shenuar nje rritje te lehte prej 0.2 perqind e krahasuar me muajin maj. Raporti i parase jashte bankave me depozitat ne muajin qershor arriti ne rreth 31.1 perqind, me nje rritje prej 0.4 perqind e krahasuar me muajin maj'06.

Depozitat ne leke, si perberesi kryesor i ofertes monetare, kane pesuar nje renie prej 0.2 miliarde leke ne krahasim me muajin maj 2006. Rritje prej rreth 3.64 miliarde leke ne krahasim me muajin maj 2006 pesuan depozitat ne valute. Norma vjetore e rritjes se tyre

ne fund te muajit qershor arriti ne 22 perqind nga 24 perqind qe ishte ne fund te muajit maj.



Rritja e depozitave në valutë gjatë muajit qershor është mbështetur kryesisht nga rritja e depozitave te sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 73.8 përqind të rritjes së depozitave totale në valutë.

Depozitat sipas Burimeve

Gjate muajit Qershor 2006:

- Sektori i individeve, zuri nivelin me te larte te depozitave pa afat ne leke me rreth 68.35 perqind, ndjekur nga sektori privat, me rreth 22.12 perqind dhe nga ndermarrjet publike jofinanciare, me 8.30 perqind.
- Individet dhe sektori privat ishin gjithashtu burimi me i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, perkatesisht me rreth 73.8 perqind dhe rreth 20.3 perqind.
- Familjarët ishin dukshëm burimi me i rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (96.71 përqind e totalit)



- Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 83.09 përqind) të depozitave totale prej rreth 453 miliardë lekë ne muajin qershor 2006. Ata ndiqen nga sektori privat (12.65 përqind), ndërrmarjet publike jo-financiare (3.38 përqind) dhe autoritetet lokale (0.72 përqind). Institucionet financiare kontribuan me rreth 0.16 për qind ne totalin e depozitave.

- Gjatë muajit qershor 2006, krahasuar me nje muaj me pare, niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit dukshem me 3.45 miliardë lekë, si rezultat i rritjes se depozitave pa afat ne leke (1.35 miliard leke), depozitave ne monedhe te huaj (3.64 miliard leke) dhe depozitave me afat në lekë u ulen (me rreth 1.54 miliardë lekë).

- Depozitat pa afat ne leke te familjareve, pesuan nje rritje prej rreth 3.49 miliarde leke, ndersa depozitat me afat ne leke te familjareve pesuan nje rritje prej rreth 0.81 miliarde leke.